



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA “ECO – ELB” sh.a

Elbasan, më .03.2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “Blerje karburanti naftë D1”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur – mallra”- Marreveshje Kuader

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 22,806,000 (njëzet e dy milion e tetëqind e gjashtëmijë)
Lekë pa TVSH

I mbajtur sot me date **.03.2023**, në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator ECO ELB sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertes, sipas shtojces 1;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Kriteret (a-c) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese vërtetimin per taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri i mesiperme eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP si dhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit te prokuruar.

b) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kriteri a) është percaktuar duke u bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe referuar nenit 43 dhe nenit 47 VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Kriteri b) është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”si dhe Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vleres se perlloritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.2 Autorizim për tregtimin e karburanteve/lëndëve djegëse lëshuar nga pushteti vendor, sipas Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet, per te gjitha pikat e stacioneve te kerkuara.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nëLigjin Nr.8450 dt.24.02.1999.

2.3.3 OE duhet të ketë pikë furnizimi në Elbasan aktive ku stacioni i furnizimit të jenë ose në qytet ose në një distancë 10 km nga Inceneratori. Pika e furnizimit duhet të punojë 24 orë pa ndërprerje.

Për të vërtetuar këtë operatori duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e qerasë shoqëruar me aktin e pronësisë të qeradhënësit.

Kriteri **2.3.3** është vendosur referuar nenit 40,41 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.4 Vërtetim teknik për respektimin e normave teknike në stacionet e tregtimit të karburanteve lëshuar nga ISHTI, i vlefshëm në datën e hapjes së ofertave.

Kriteri **2.3.4** bazuar ne nenin 77 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.5 Çdo operator ekonomik duhet që të sjellë bashkëngjitur me ofertën, fletë analizat të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial “**ISHTI**” ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj materiali duhet i perkthyer dhe e noterizuar në shqip) për artikullin Gazoil (10ppm USLD).Enti certifikues (laboratori) duhet të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqiperisë (të paraqitet dokumenti akreditimit të laboratorit)

Kriteri **2.3.5** është vendosur referuar nenit 40,pika 5,germa a, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.6 *Bazuar ne VKM Nr. 561, date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojne mundësinë që shërbimi i furnizimit me karburant të kryhet me kartë elektronike, gjë që mundëson identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e saj.*

2.3.7 O.E. fitues duhet të deklarojë se merr përsipër që të dorëzojë, bashkangjitur me çdo faturë për likuidim, një database me të dhëna si : targon e mjetit ,sasine e furnizimit, daten, orën dhe personin përdorues te mjetit, ***gjë që mundëson identifikimin e mjetieve te autoritetit kontraktor dhe përdoruesin e saj.***

2.3.8 O.E duhet të deklarojë, se merr përsipër që të konvertojë të gjitha furnizimet me karte elektronike, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Karta elektronike duhet te jete e vlefshme dhe e perdorshme gjate gjithe periudhes se vlefshme te kontrates.

Kriteri **2.3.6, 2.3.7 dhe 2.3.8** është vendosur referuar nenit 40,pika 5,germa a, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” si dhe Bazuar ne VKM Nr. 561, date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit”

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me autobot te posaçëm për transport karburanti së bashku me aparatit matës të vërtetuar me :

- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Foto te mjetit dhe autobotit te posaçëm

Kur mjeti eshte me qira duhet te paraqese :

- Kontrates e qirase te vlefshme per periudhen e furnizimit me katrburant.
- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Foto te mjetit dhe autobotit te posaçëm.
- Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2.3.10 Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratë për të marrë përsipër furnizimin me shërbim 24 orë në të gjitha pikat.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose

tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njesia e Prokurimit